

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6267
E enjte, 18 mars 2021
çmimi 0.40 €

Seanca e radhës ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, më 24 mars

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË 24 ORËT E FUNDIT NË KOSOVË NGA COVID-19 KANË HUMBUR JETËN EDHE TETË PACIENTË, NDËRKAQ JANË KONFIRMUAR EDHE 709 RASTE TË REJA ME KËTË VIRUS

FAQE 4-5

RRITET NUMRI I RASTEVE ME COVID, MASAT MBESIN TË NJËJTA, VAKSINA ASKUND



Në Kosovë të mërkurën kanë humbur jetën edhe tetë pacientë si pasojë e infektimit me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka raportuar edhe për 709 raste të reja me Covid. Në 24 orët e fundit më së

shumti raste janë konfirmuar në Prishtinë, gjithsej 242. Duke parë situatën me këtë virus, spitalet në gjithë vendin janë pajisur edhe me 60 shtretër modernë për pacientët e prekur me Covid. Ditët e fundit, me rritjen e numrit të të infektuarve me

Covid, është rritur edhe kërkesa për plazmat e gjakut. Në këtë drejtim është bërë thirrje që të nisët një fushatë e mobilizimit të dhënies së gjakut të atyre që kanë kryer Covidin dhe që kanë antitropa të mjaftueshme

ANALISTËT: QEVERIA E RE DUHET TA NDRYSHOJË QASJEN NDAJ DIALOGUT



Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi presin që qeveria e re ta ndryshojë qasjen ndaj këtij procesi. Ata kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se qeveria Kurti duhet të jetë proaktive në këtë proces. Hulumentuesit nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) kanë vlerësuar se Kosova duhet t'i shfrytëzojë rrethanat e favorshme ndërkombëtare për këtë proces. Sipas tyre, qeveria e re duhet të përpilojë një platformë të qartë dialoguese me parime dhe qëndrime të mirëfillta

FAQE 3

INTEGRITETI I PROCESIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOMUNA VAZHDON TË JETË I CENUESHËM

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



SERBISË DHE MALIT TË ZI U
OFROHET RRUGË MË E
SHKURTËR PËR NË BE F. 8

HOXHAJ VAZHDON TAKIMET ME
STRUKTURAT E PARTISË PËR
ZGJEDHJET LOKALE F. 7

PËRKUJTOHET 22-VJETORI I
BETEJËS SË KABASHIT F. 6



EKONOMI



AS SOT NUK KA TRANSPORT
PUBLIK, PARALAJMËROHET
PROTESTË PËR TË PREMTEN F. 9

LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE
PRITET TË SJELLË PËRFITIME
PËR QYTETARËT F. 9

SPORT

PRISHTINA DHE DUKAGJINI, NË
GJYSMËFINALE TË KUPËS F. 14

KE-ja propozon "Covid-pasaporta" për lehtësimin e udhëtimit brenda BE-së

BRUKSEL, 17 MARS - Komisioni Evropian ka propozuar të mërkurën lehtësimin e "pasaportës së gjelbër për Covid-19", përmes së cilës synohet lehtësimi i lëvizjes së njerëzve brenda Bashkimit Evropian në kohën e pandemisë. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë gjatë paraqitjes së këtij propozimi, se synimi është që sa më parë të mundësohet lëvizja e lirë e njerëzve dhe kjo është e mundur në afat të gjatë vetëm përmes vaksinimit gjithëpërfshirës. Komisioni Evropian ka sqaruar se këto pasaporta do të kenë tri

elemente, të cilat do të duhej të ishin të mjaftueshme për të mundësuar lëvizjen e njerëzve. Elementi i parë përmban vërtetimin për vaksinim kundër Covid-19, i dyti, vërtetimin për test negativ në këtë virus dhe i treti, vërtetim se personi është shëruar nga sëmundja Covid-19. Të gjitha këto pasaporta duhet të përfshijnë edhe të dhënat për datën e vaksinimit apo testimin, emrin e institucionit që e ka bërë testin apo vaksinimin, emrin e vaksinës dhe afatin e vërtetimit. Për momentin, sipas sqarimeve të Komisionit Evropian, pasaportat duhet të lëshohen në të gjitha vendet e BE-së dhe

të pranohen në të gjitha shtetet e tjera të BE-së si dhe shtetet e Zonës Shengen, të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian ka nënvizuar se edhe shtetasit e huaj, me qëndrim në BE, kanë të njëjtat mundësi dhe të drejta për t'u pajisur me pasaporta. Sa iu përket pasaportave të lëshuara nga shtetet e tjera joanëtare të BE-së, ato do të shqyrtohen nga Komisioni më vonë në bazë të standardeve të cilat i kanë aplikuar ato vende. Për momentin, pasaportat për vaksinim që do të vlejnjë në tërë territorin e BE-së, të cilat vërtetojnë se personi është



vaksinuar me njëren prej vaksinave, të cilat janë miratuar për përdorim në tregun e BE-së. Por, shtetet anëtare mund të vendosin vetë që ta pranojnë edhe vaksinimin me vakcina të tjera. Kjo çështje është

parashtruar si problem për shkak se disa shtete të BE-së kanë nisur t'i vaksinojnë qytetarët e tyre edhe me vakcina nga Rusia dhe Kina, të cilat ende nuk janë miratuar nga autoritetet e BE-së.

Greqia i kërkon Turqisë ta zbatojë marrëveshjen për migrantët

ATHINË, 17 MARS - Ministri i Migracionit në Greqi, Notis Mitarachi, i ka bërë thirrje Turqisë të marrë mbrapa 1 450 migrantët. Ky veprim, sipas tij, do të tregonte gatishmërinë e Ankarasë për të bashkëpunuar me Bashkimin Evropian në kuadër të marrëveshjes të vitit 2016. "Ne i kemi propozuar Turqisë që t'i rifillojë kthimet e atyre që nuk kanë të drejtë për të fituar mbrojtje", i tha Mitarachi agjencisë AFP. Marrëveshja Turqi - BE obligonte shtetin turk t'i mbajë azilkërkuesit, kryesisht nga Siria, në këmbim të një pagese prej 6 miliardë eurosh nga ana e BE-së. Sipas



Komisionit Evropian, 4.1 miliardë euro tashmë janë transferuar në Turqi dhe dy

miliardat e mbetura janë kontraktuar në projekte për t'i mbështetur refugjatët.

Por, Ankaraja kundërshton shifrat e BE-së, duke pretenduar se vetëm 3.6 miliardë euro janë shpenzuar për sirianët. Turqia mban rreth 3.7 milionë sirianë në tokën e saj. "Turqia ka ndërmarrë përgjegjësi të caktuara, sikurse ka bërë BE-ja. Të dyja palët duhet të përmbushin këto detyrime", ka ministri grek. Që nga arritja e marrëveshjes ka rënë ndjeshëm numri i migrantëve dhe refugjatëve në Greqi. Në kulmin e krizës në vitin 2015, Detin Egje e kaluan 856 000 migrantët. Kjo shifër ra në 173 000 vitin e ardhshëm, dhe në vetëm 30 000 më 2017. Mbase

për shkak të pandemisë, në vitin 2020 kjo shifër ishte vetëm 10 000! Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, disa herë ka kërcënuar me prishje të marrëveshjes. Ai dëshiron përparim në procesin e integritimit të Ankarasë në Bashkimin Evropian. Ankaraja gjithashtu dëshiron që Brukseli të bashkëpunojë me Turqinë në krizën e Sirisë, për të përgatitur rrugën që refugjatët të kthehen në atdheun e tyre të shkatërruar nga lufta. Shtetet anëtare të BE-së do të diskutojnë në lidhje me Turqinë në samitin e tyre të ardhshëm më 25 dhe 26 mars.

Papa bën thirrje për ndaljen e dhunës në Mianmar

Vatikan, 17 mars - Papa Françesku bëri thirrje për t'i dhënë fund gjakderdhjes në Mianmar. "Edhe unë gjunjëzohem në rrugët e Mianmarit dhe them: ndal dhunën", ka thënë Papa gjatë një audience të mbajtur në distancë, nga biblioteka e Vatikanit, për shkak të kufizimeve të pandemisë. Më 1 shkurt ushtria mori pushtetin në Mianmar dhe burgosi zyrtarët e lartë shtetëror. Që nga ajo kohë janë

zhvilluar protesta kundër sundimit ushtarak, dhe deri më tani llogaritet se janë vrarë rreth 180 protestues. "Edhe një herë dhe me shumë trishtim ndiej urgjencë të flas për situatën dramatike në Mianmar, ku shumë njerëz, shumica e tyre të rinj, po humbin jetën në mënyrë që t'i ofrojnë shpresë vendit të tyre", ka deklaruar Papa Françesku. Në Mianmar ka rreth 800 000 katolikë. Shumica e popullsisë janë budistë.



Trumpi u bën thirrje mbështetësve republikanë që të vaksinohen

WASHINGTON, 17 MARS - Ish-presidenti amerikan Donald Trump u ka bërë thirrje mbështetësve republikanë që të vaksinohen kundër Covid-

19, sëmundjes që shkakton koronavirusi, duke thënë se ai do ta rekomandonte një gjë të tillë. Në një intervistë televizive, ai ka thënë se vakcina është "e

sigurt" dhe "diçka që funksionon". Baza e përkrahësve konservatorë të Trumpit ka qenë një prej grupeve kryesore që i ka rezistuar programit të

vaksinimit. Ish-presidenti amerikan është kritikuar gjatë periudhës sa ka qenë në Shtëpi të Bardhë për minimizim të rrezikut të pandemisë.

Analistët politikë flasin për pritjet e qeverisë së re në raport me dialogun Kosovë - Serbi

Analistët: Qeveria e re duhet ta ndryshojë qasjen ndaj dialogut

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi presin që qeveria e re ta ndryshojë qasjen ndaj këtij procesi. Ata kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se qeveria Kurti duhet të jetë proaktive në këtë proces. Hulumtuesit nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) kanë vlerësuar se Kosova duhet t'i shfrytëzojë rrethanat e favorshme ndërkombëtare për këtë proces. Sipas tyre, qeveria e re duhet të përpilojë një platformë të qartë dialoguese me parime dhe qëndrime të mirëfillta

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 MARS - Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se qeveria e re duhet ta ndryshojë qasjen ndaj këtij procesi.

Hulumtuesit nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se qeveria Kurti duhet të jetë më proaktive.

Violeta Haxholli nga KDI-ja ka deklaruar për gazetën se qeveria Kurti duhet ta trajtojë më me seriozitet dialogun Kosovë - Serbi. "Po me qeverinë e re pritjet një ndryshim sa i përket qasjes ndaj dialogut. Ekzekutivi i ri ka paralajmëruar rivlerësim të procesit dhe marrëveshjeve të dialogut. Po ashtu, kryeministri në ardhje ka deklaruar se dialogu nuk është një nga prioritetet kryesore. Në këtë drejtim ne si KDI mendojmë se dialogu duhet të trajtohet me seriozitet, sepse qeveria ka mandat kushtetues që të merret edhe me politikën e brendshme dhe atë të jashtme dhe këto të dyja nuk duhet të jenë zëvendësime për njëra-tjetrën. Pra, nga qeveria e re dhe kryeministri i ri pritjet që të trajtojë të dy këto domene me prioritet", ka vlerësuar Haxholli. Ajo ka bërë me dije se tani Kosova duhet t'i shfrytëzojë rrethanat e favorshme ndërkombëtare për këtë proces. "Po ashtu, rrethanat ndërkombëtare aktualisht janë të favorshme për Kosovën, sidomos

duke pasur në administratën amerikane një president si z. Joe Biden i cili ka deklaruar vetë se ka raporte speciale me Kosovën. Prandaj shteti i Kosovës duhet të përfitojë nga këto rrethana që t'i shtyjë përpara kërkesat e saj ndaj Serbisë dhe dialogut duke pasur parasysh që ka ende shumë çështje që nuk janë adresuar nga ana e Serbisë si kërkimfalja, të pagjeturit, dëmet e luftës, moszbatimi i shumë marrëveshjeve të dialogut etj", është shprehur ajo, duke shtuar se institucionet e reja duhet të llojnë tek administrata amerikane për kërkesat e tyre.

"Pra, në vend se të ketë rezistencë ndaj dialogut, duhet të ketë lobim të partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht tek administrata amerikane mbi kërkesat e Kosovës ndaj Serbisë", ka deklaruar Haxholli, duke shtuar se një artikullim i mirë i kërkesave dhe një strategji e mirë lobimi është ajo që duhet të bëjë pala e Kosovës në këtë proces.

Edhe Arbër Fetahu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka thënë se pret një qasje proaktive të qeverisë në këtë proces. Ai ka thënë se qeveria e re nuk duhet të këmbëngulë në njohjen reciproke. "Është mirë të pritjet konstituimi i institucioneve për të parë qartë se si do të vazhdohet dialogu me Serbinë, apo më mirë thënë si do të jetë qasja në këtë proces për arsye që të mos paragjykojmë pozicione apo veprime që do të mbajë qeveria e re. Sidoqoftë, në aspektin se si duhet të jetë qasja në dialog nga kjo qeveri, atëherë unë pres një qasje proaktive jo defanzive, që nënkupton propozim temash, kërkesa për zbatim marrëveshesh nga Serbia dhe ngulmim për një rezultat final me njohje të ndërsjellë", ka vlerësuar Fetahu. Sipas tij, qeveria e re

duhet të përpilojë një platformë të qartë dialoguese me parime dhe qëndrime të mirëfillta. "Kjo qeveri e ka të gjithë legjitimitetin dhe fuqinë politike e që, ndoshta, qeveritë e tjera nuk e kanë pasur që ta shtyjë përpara këtë proces me një qasje serioze. Unë pres që të përpilojë një platformë e qartë dialoguese me parime dhe qëndrime të mirëfillta, e konsultuar edhe me partitë e tjera parlamentare, që pozicioni i Kosovës të jetë i fortë. Gjithashtu, do të ishte e dëshirueshme një kërkesë për një angazhim edhe më direkt të ShBA-së karshi BE-së në këtë proces, dhe Kosova ta luajë rolin përbashkues e jo të shërbejë si përçarës për këto dy superfuqi", ka thënë Fetahu.

Opozita i kërkon Kurtit sqarime për dialogun

Opozita ka kërkuar sqarime për dialogun Kosovë - Serbi nga fituesi i zgjedhjeve të 14 shkurtit. Kryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, pas takimit konsultativ me Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, ka thënë se ata duhet t'i sqarojnë disa çështje në lidhje me këtë proces. "Kam kërkuar të di qëndrimin e tyre për dialogun për

normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë me qëllimin përfundimtar të njohjes reciproke. A do ta mbajnë ata premtimin e dhënë për qytetarët e Kosovës se nuk do të fillojë dialogu me Serbinë pa një kërkimfalje zyrtare nga Serbia dhe kthimin e të gjithë personave të zhdukur? Kam kërkuar të di qëndrimin e tyre në lidhje me Asociacionin e Komunave Serbe. A do ta sjellin në Kuvend anulimin e këtij projekti dhe të marrëveshjeve të Brukselit?", ka thënë Hoxhaj.

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ftuar të dyja palët për vazhdim të dialogut. BE-ja ka bërë me dije se takimin e radhës midis Kosovës dhe Serbisë do ta thërrasin pas formimit të institucioneve të reja në Kosovë, të dala nga zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit.

Kurse i dërguari i Departamentit Amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, së fundi ka zhvilluar takime online me përfaqësuesit politikë të të dy shteteve, me të cilët ka biseduar për rinisjen e këtij procesi. Në këto takime Palmer ka vlerësuar se Shtetet e Bashkuara e mbështesin procesin e udhëhequr nga Bashkimi Evropian, duke shtuar se pret që vazhdimi i dialogut të pasojë së shpejti.

Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur në mars të vitit 2011.

Në këtë periudhë dhjetëvjeçare janë zhvilluar dhjetëra takime dhe janë nënshkruar shumë marrëveshje, por procesi ende nuk ka prodhuar një marrëveshje finale në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Procesi i dialogut Kosovë - Serbi kishte nisur me bisedimet për çështje teknike, ndërkaq në vitin 2012 kishte evoluuar në bisedime politike, për të kaluar më pas në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, me përfaqësimit të nivelit të lartë politik, ndërmjet kryeministrave dhe presidentëve të të dyja vendeve.



Seanca e radhës ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, më 24 mars

PRISHTINË, 17 MARS (ER) - Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë njoftuar se më 24 mars, duke filluar nga ora 11:00, do të mbahet konferencë për ecurinë e çështjes ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe të tjerëve. Seanca do të mbahet ndaj katër ish-udhëheqësve politikë dhe ushtarakë të UÇK-së, ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri

Veseli e Jakup Krasniqi dhe ish-shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosjes, Rexhep Selimi. Aktakuza i bën përgjegjës Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin për një sërë krimesh që pretendohet se janë kryer gjatë viteve 1998-1999. Zyra e Prokurorit të Specializuar i ka dhënë përgjigje edhe kërkesës së mbrojtjes për rishikimin e vendimit për ndalimin e të

akuzuarit Salih Mustafa. Sipas prokurorisë, vazhdimi i ndalimit të Mustafës është i domosdoshëm. Ajo ka vlerësuar se rreziku që ai të ndërhyjë te dëshmitarët nuk ka ndryshuar. "Për këto arsye Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkon që gjyqtari i procedurës paraprake ta anulojë kërkesën e mbrojtjes dhe thërret që i akuzuari të mbetet në ndalim", thuhet në njoftimin për media.





NË 24 ORËT E FUNDIT NË KOSOVË NGA COVID-19 KANË HUMBUR JETËN EDHE TETË PACIENTË, NDËRKAQ JANË KONFIRMUAR EDHE 709 RASTE TË REJA ME KËTË VIRUS

Rritet numri i rasteve me Covid, masat mbesin të njëjta, vaksina askund

Në Kosovë të mërkurën kanë humbur jetën edhe tetë pacientë si pasojë e infektimit me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka raportuar edhe për 709 raste të reja me Covid. Në 24 orët e fundit më së shumti raste janë konfirmuar në Prishtinë, gjithsej 242. Duke parë situatën me këtë virus, spitalet në gjithë vendin janë pajisur edhe me 60 shtretër modernë për pacientët e prekur me Covid. Ditët e fundit, me rritjen e numrit të të infektuarve me Covid, është rritur edhe kërkesa për plazmat e gjakut. Në këtë drejtim është bërë thirrje që të nisët një fushatë e mobilizimit të dhënies së gjakut të atyre që kanë kryer Covidin dhe që kanë antitropa të mjaftueshëm

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 4 388 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar (ShSKUK) dhe gjurmimi i

kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 709 raste pozitive.

Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan dy raste (74, 60 vjeç), Prishtinë dy raste (89, 76 vjeç), Kaçanik një rast (76 vjeç), Podujevë një rast (70 vjeç), Rahovec një rast (62 vjeç), Skenderaj një rast (64 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 79 089 raste nga 366 574 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 1 731 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 385 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 65 979 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 379.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 242 raste, Gjilan 61 raste, Fushë-Kosovë 60 raste, Pejë 51 raste, Gjakovë 41 raste, Kamenicë 41 raste, Mitrovicë 35 raste, Ferizaj 33 raste, Podujevë 18 raste, Viti 18 raste, Obiliq 16 raste, Vushtrri 12

raste, Skenderaj 11 raste, Prizren 10 raste, Suharekë 10 raste, Drenas 9 raste, Lipjan 9 raste, Istog 6 raste, Novobërdë 6 raste, Klinë 5 raste, Rahovec 5 raste, Deçan 4 raste, Shtime 3 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Kaçanik dhe Kllokot.

IKShPK-ja bën thirrje për respektim të masave kundër Covidit

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se numri i rasteve pozitive dhe vdekjeve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. "Mjekët të stërngarkuar në spitale po luftojnë kundër këtij virusi tinëzar e shkatërrimtar me tërë fuqinë e tyre profesionale dhe njerëzore. IKShPK-ja përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19", është thënë në njoftimin e

IKShPK-së.

Ky institut ka bërë thirrje që të qëndrohet në shtëpi, dhe dalja të jetë vetëm për nevoja të domosdoshme. "Ndalimi rigoroz i takimeve me njerëz me të cilët nuk jetoni në bashkësi, pos për qëllime specifike; ndalimi rigoroz i tubimeve; respektimi rigoroz i masave kufizuese në aktivitetet publike; kufizimi i punës për veprimtaritë joesenciale dhe vendngjarjet duke reduktuar edhe kohën e punës gjatë ditës", thuhet në mesazhin e IKShPK-së.

Spitalet pajisen me 60 shtretër modernë për pacientët e prekur me Covid

Njëzetë shtretër modernë për përkujdesje intensive, me katër thyerje, që dirigjohen nga dy telekomandues, të cilët e bëjnë më të lehtë dhe më të përshtatshëm qëndrimin e gjatë të pacientit, janë vendosur në



drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. “Po ashtu, kemi dërguar edhe pajisje të ndryshme si: analizues i gjakut, pajisje për oksigjenoterapi me rrjedhje të lartë, pompa seksioni dhe helmata. Shtretërit dhe të gjitha këto pajisje janë në kuadër të blerjeve të Ministrisë së Shëndetësisë nëpërmjet UNOPS-it”, ka treguar ministri Zemaj.

Ai ka theksuar se kuadri shëndetësor e ka të domosdoshëm plotësimin e kushteve, nevojave për barna, material shpenzues dhe pajisje cilësore për të qenë në krye të detyrës. Shtretërit e rinj janë pjesë e “Projektit emergjent Covid-19 për Kosovë”, i financuar nga një kredi e Bankës Botërore - përmes UNOPS-it.

Mbesin në fuqi masat e njëjta kundër Covid-19

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka takuar të martën ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Naser Ramadani, drejtorin e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi dhe zëvendësministrin e Arsimit, Xhavit Rexhaj, me të cilët ka biseduar për gjendjen me pandeminë Covid-19. Në këtë takim është vendosur që të mbesin në fuqi masat e njëjta kundër Covid-19, pasi është vlerësuar se trendët janë stabilë. Ndërkohë që po shqyrtohen mundësitë për fillimin e mësimit online në të gjitha nivelet e arsimit, për dy javët e ardhshme, duke filluar nga 22 marsi.

Edhe në këtë takim qytetarëve u



kërkohej ta respektojnë distancën fizike, t'i përdorin maskat dhe ta mirëmbajnë higjienën personale.

Nga institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të masave kundër Covid-19, kërkohet që ta ngrehin nivelin e angazhimit përmes respektimit rigoroz të masave në fuqi. Pavarësisht prej ngarkesave, institucionet shëndetësore po funksionojnë me kapacitete të plota dhe furnizimi me barna është stabil. Ndërsa Komiteti për Imunizim dhe institucionet përkatëse janë duke i kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme që sapo të arrijë kontingjenti i parë i vaksinës “Covax”, menjëherë të fillojë vaksinimi i qytetarëve.

Rritet kërkesa për plazmat e gjakut

Ditët e fundit, me rritjen e numrit të të infektuarve me Covid, është rritur kërkesa për plazmat e gjakut të cilat përmbajnë mbi 50 antitropa. Profesori universitar Valon Murati ka thënë se këto ditë kemi parë edhe shumë figura publike të kenë nevojë për vete apo kërkojnë ndihmë për

familjarët e tyre. “Duke pasur parasysh vështirësitë e tyre, mund ta marrim me mend se sa të vështirë e kanë njerëzit që nuk kanë të njëjtën qasje në rrjetet sociale dhe në mediat tona. Andaj do të ishte mirë që Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, së bashku me QKUK-në, IKShP-në dhe me Ministrinë e Shëndetësisë të nisnin një fushatë të mobilizimit të dhënies së gjakut të atyre që e kanë kryer Covidin dhe kanë antitropa të mjaftueshëm. Besoj solidariteti nuk do të mungojë, ashtu siç edhe po ka përgjigje në këto thirrjet individuale, por duhet një organizim shtetëror në mënyrë që efekti të jetë më i madh dhe të ketë plazma për të gjithë ata që kanë nevojë”, ka thënë Murati.

Kosova ende pa asnjë vaksinë kundër virusit “Korona”

Është mbushur një vjet prej që Kosova është prekur nga pandemia Covid-19, ndërsa ende nuk ka arritur asnjë dozë e vaksinës kundër Covidit. Derisa

vendet e rajonit kanë filluar vaksinimin e qytetarëve kundër këtij virusi, në Kosovë ende nuk dihet data e saktë se kur mund të arrijë vaksina. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se brenda pak javësh vaksina do të arrijë edhe në Kosovë. “Tash jemi në fazën finale të kësaj pandemie në bazë edhe të vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare lidhur me këtë pandemi. Për disa javë ne presim arrijtjen e vaksinave dhe do ta fillojmë vaksinimin masiv bazuar në strategjinë e imunizimit që tashmë është përgatitur. Të gjitha përgatitjet janë bërë në këtë drejtim”, ka deklaruar Hoti, duke shtuar se Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK-ja i kanë bërë të gjitha përgatitjet teknike për të filluar vaksinimi. “Më lejoni të them edhe një herë, edhe për vaksinën jemi kritikuar, por ne kemi bërë të gjitha përgatitjet për ta sjellë vaksinën sipas standardeve të BE-së. Nuk kemi hyrë në lojëra për ta sjellë vaksinën nga vendet e Lindjes, të cilat vaksina nuk janë të certifikuara nga vendet e Bashkimit Evropian”, ka thënë para disa ditësh kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti.



Policia sekuestron një armë gjuetie në fshatin Poklek të Drenasit

DRENAS, 17 MARS (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë është duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme policore për ta siguruar rendin dhe qetësinë publike në rajonin e Prishtinës. Në kuadër të veprimeve operative, me qëllim parandalimin dhe

zbulimin e veprave kriminale, të mërkurën në fshatin Poklek i vjetër, me urdhëresë të Gjykatës Themelore, nga njësitet policore të Drenasit është kryer një kontroll në një shtëpi, ku janë gjetur dhe sekuestruar: një pushkë gjuetie, 22 fishekë si dhe një

kartoni).

Personi i dyshuar V. M., mashkull, 30 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës, është shoqëruar në stacion policor dhe ndaj tij, në konsultim me prokurorin e shtetit, është iniciuar rast për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës.



Përkujtohet beteja e Kabashit

PRIZREN, 17 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, me rastin e shënimit të 22-vjetorit të betejës së Kabashit, së bashku me familjet e dëshmorëve, drejtorët komunalë dhe shoqatat e dala nga lufta, ka bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Landovicë. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka deklaruar se pothuajse secila ditë e muajit mars në vete përmban një histori të veçantë të heronjve të lirisë,

duke filluar prej demonstratave deri në shënimin e betejave më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Më 17 mars të vitit 1999 ranë për të mos vdekur kurrë tre dëshmorë të kombit: Halim Ahmetaj, Rexhep Kukaj dhe Murat Kabashi. Lavdi të përjetshme veprës dhe sakrificës së tyre! Lavdi për të gjithë dëshmorët e kombit!", është shprehur kryetari Haskuka.

Komuna e Deçanit nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Telekomin

DEÇAN, 17 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pritur në takim kryeshefin ekzekutiv të Telekomit, Zeqir Kiqina, me të cilin ka shkruar memorandum bashkëpunimi.

Ky memorandum i bashkëpunimit ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe Komunës së Deçanit ka për qëllim mbulimin e rrjetit të telekomunikacionit me fibër optik përgjatë rrugës nacionale Deçan - Plavë dhe mbulimin e rrjetit mobil të zonave turistike në parkun nacional të Komunës së Deçanit.

Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ky memorandum bashkëpunimi është i një rëndësie të veçantë për komunën që drejton. "Kjo

ditë e nënshkrimit të këtij memorandumit, për mua si i pari i komunës, do të jetë një datë me rëndësi të veçantë, sepse çdo ditë e më shumë po afrohem drejt realizimit të ëndrrës sonë për zhvillim të turizmit në bjeshkët e Komunës së Deçanit", ka deklaruar Ramosaj.

Edhe kryeshefi ekzekutiv i Telekomit, Zeqir Kiqina, ka theksuar se ky memorandum është tepër i rëndësishëm për kompaninë që drejton, po ashtu edhe për Komunën e Deçanit dhe vizitorët e këtyre bjeshkëve. Afati i realizimit të memorandumit të bashkëpunimit i nënshkruar të mërkurën do të implementohet mes viteve 2021-2023.



Drejtoria e Inspeksionit merr aksion për lirimin e hapësirave publike në Gjakovë



GJAKOVË, 17 MARS (ER) - Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës ka ndërmarrë aksion për lirimin e hapësirave publike në këtë qytet. Drejtori për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës, Fazli Hoxha, në një deklaram për media ka treguar qëllimin e këtij aksioni. "Angazhimi i radhës

në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese ishte lirimi i hapësirave publike në qytetin e Gjakovës. Një aksion të tillë e morëm për t'i liru hapësirat publike që janë bllokuar nga veturat e parkuara vend e pavend, ku po vështirësohet edhe lëvizja e kalimtarëve, si dhe po dëmtohen drunjtë dekorativë në qytetin tonë. Veprimet e

tilla u shërbejnë të gjithëve për të lehtësuar qarkullimin e këmbësorëve, ruajtjen e drunjve të mbjellë dhe, para së gjithash, krijimin e një ambienti ashtu siç e meritojnë qytetarët e Gjakovës. Çdo veprim po bëhet në të mirë të qytetit tonë dhe qytetarëve", ka deklaruar Fazli Hoxha, drejtor për Punë Inspektuese.

Ambasadori britanik uron Abdixhikun për zgjedhjen kryetar i LDK-së

PRISHTINË, 17 MARS (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, me bashkëpunëtorë, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott.

Abdixhiku e ka njoftuar ambasadorin Abbott për synimet dhe programin e tij në LDK dhe për qëndrimet e

kësaj partie rreth situatës aktuale politike në vend dhe për formimin e institucioneve të Kosovës. Abdixhiku e ka falënderuar ambasadorin Abbott për mbështetjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Republikës së Kosovës në të gjitha periudhat.

Duke e uruar Abdixhikun për detyrën e re, ambasadori britanik Nicholas Abbott ka thënë se Mbretëria e

Bashkuar do të vazhdojë t'i përkrahë institucionet e Kosovës dhe do të jetë partnere në projektet që synojnë zhvillimin e Kosovës, forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe fusha të tjera.

Po gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e mirë mes dy vendeve dhe për mundësitë e thellimit të këtij bashkëpunimi.



Integriteti i procesit të prokurimit publik në komuna vazhdon të jetë i cenueshëm

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 MARS - Iniciativa për Progres (INPO) në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD) të mërkurën në një konferencë për media kanë publikuar dy raporte të monitorimit të Prokurimit Publik në komuna. Raporti "Planifikimi i prokurimit në komuna" përmban gjetjet dhe rekomandimet rreth planifikimit të prokurimit publik në 20 komuna të Republikës së Kosovës.

Monitorimi i planifikimit të prokurimit publik në komuna ka përfshirë analizimin e planeve të prokurimit për vitin fiskal 2020, të komunave të fokusit, duke analizuar nëse të njëjtat plotësojnë kërkesat ligjore për hartimin e tyre.

Analiza ka përfshirë mesatarisht pesë aktivitete të prokurimit të kategorisë punë dhe pesë aktivitete për furnizime.

Hulumtuesja e INPO-s, Samire Sahiti, gjatë prezantimit të raportit ka thënë se në kuadër të hulumtimit, fillimisht është analizuar planifikimi sa iu përket aktiviteteve për punë, përkatësisht është analizuar nëse vlera e aktiviteteve të planifikuara për punë a përputhet me kapacitetin buxhetor që komunat kanë në dispozicion. Gjetjet tregojnë se sa iu përket aktiviteteve për punë, përveç Komunës së Kamenicës, Mitrovicës së Veriut, Vitisë dhe Glogocit, komunat e tjera kanë planifikuar të shpenzojnë



shumë më shumë sesa që kanë buxhet në dispozicion. Kryesisht këto dallime të mëdha janë pasojë e asaj se komunat dështojnë që në plane të prokurimit të saktësojnë që projekti është me kohëzgjatje një, dy apo më shumë vjeç.

Ajo ka thënë se komunat kanë iniciuar aktivitete për punë në vlerë më të madhe sesa ajo që është planifikuar për aktivitete. Kjo dukuri e mosrespektimit të planit të prokurimit vërehet te të gjitha komunat e monitoruar, përjashtuar Komunën e Mitrovicës së Jugut, Deçanit, Gjakovës, Mitrovicës së Veriut, Vushtrisë dhe Leposaviqit.

Ndërkaq sa i përket planifikimit të aktiviteteve të prokurimit për kategorinë

furnizim, gjetjet e raportit tregojnë se asnjë nga komunat e monitoruara nuk kanë përmbushur kërkesat dhe standardet ligjore për planifikim.

Ndërkaq Qëndrim Arifi gjatë prezantimit të raportit "Raporti i monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik në komuna" ka pohuar se raporti përmban një mori gjetjesh të cilat i karakterizojnë shumicën e komunave të monitoruara dhe gjetje të tjera të veçanta që janë karakteristikë e vetëm një komune.

Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti janë bërë nga monitorimi i 81 aktiviteteve të prokurimit, respektivisht 41 aktivitete të prokurimit janë monitoruar

nga faza e inicimit e deri te nënshkrimi i kontratës dhe 40 aktivitete të menaxhimit. Monitorimi përfshinë 20 komuna të Republikës së Kosovës. Secilës komunë mesatarisht i janë monitoruar dy aktivitete të prokurimit nga faza e inicimit deri te nënshkrimi i kontratës dhe dy aktivitete të menaxhimit të kontratave, përkatësisht nga faza e nënshkrimit deri në përfundim të implementimit të kontratës. "Në përgjithësi gjetjet tregojnë se integriteti i procesit të prokurimit publik në komunat e Kosovës vazhdon të jetë i cenueshëm. Diskriminimi apo trajtimi jo i barabartë i OE-ve si rezultat i vendosjes së kriterëve diskriminues në dokumentet e tenderit, të cilat krijojnë

pabarazi dhe kufizim të konkurrencës, vazhdon të jetë problem kryesor në komuna", ka thënë Arifi.

Në këtë konferencë u rekomandua që komunat të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive për ngritjen e transparencës mbi mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e të gjithë zyrtarëve të përfshirë në procedura të prokurimit publik, të cilët haptas veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket planifikimit të prokurimit, afateve për tenderim, aplikimit të kriterëve kufizues/diskriminues dhe të tjera veprime që e cenojnë në çfarëdo forme integritetin e proceseve të prokurimit publik.

Hoxhaj vazhdon takimet me strukturat e partisë për zgjedhjet lokale

PEJË, 17 MARS (ER) - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka takuar kryesitë e degëve të PDK-së në Pejë, Gjakovë dhe Deçan, për të diskutuar për rezultatin zgjedhor të 14 shkurtit.

"Gjatë takimeve analizuar disa çështje lidhur me hapat që duhet të ndërmarrim si parti për t'u përgatitur për zgjedhjet lokale. Po ashtu, shpreha mirënjohjen time për secilin anëtar, për angazhimin dhe lojalitetin

e treguar ndaj partisë, gjatë dhe pas zgjedhjeve të 14 shkurtit. Partia Demokratike e Kosovës do të jetë opozitë konstruktive në shërbim të interesave të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Hoxhaj pas këtyre takimeve.



Serbisë dhe Malit të Zi u ofrohet rrugë më e shkurtër për në BE

PRISHTINË, 17 MARS - Në Bashkimin Evropian (BE) janë duke vazhduar përgatitjet që Mali i Zi dhe Serbia të përfshihen në metodologjinë e re të zgjerimit të bllokut, që ishte miratuar në shkurt të vitit 2020.

Në një dokument të brendshëm, të përgatitur nga Komisioni Evropian për shtetet anëtare, janë paraqitur hapat përmes të cilave edhe Mali i Zi dhe Serbia do të përfshihen në këtë metodologji. Në parim, metodologjia e re aplikohet ndaj shteteve të cilat, në kohën e miratimit të saj, nuk kishin nisur negociatat e anëtarësimit, në këtë rast Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Por, që prej se ishte miratuar kjo metodologji ishte thënë se edhe këto dy shtete mund të përfshihen në këtë metodologji të re "me kusht që edhe ato të pajtohen me këtë".

Metodologjia e re e zgjerimit

parashih grupimin e disa kapitujve në një tërësi dhe hapjen dhe mbylljen e tyre në të njëjtën kohë. Po ashtu, parashihet edhe dinamizmi i kontakteve politike, por edhe fokusimi më i madh në kapitujt që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.

Në këtë dokument propozohet që Mali i Zi dhe Serbia nuk mund të mbyllin asnjë kapitull të ri negociues, nëse nuk vërtetohet se i kanë përmbushur të gjitha kushtet kalimtare nga kapitujt 23 dhe 24, që kanë të bëjnë me gjyqësorin, të drejtat themelore dhe rendin e ligjit. Po ashtu, këta kapituj do të mbyllin vetëm në fund të procesit.

Edhe në këtë dokument, në rastin e Serbisë, përmendet kusht edhe progresi për normalizimin e raporteve me Kosovën në kuadër të dialogut të cilin e lehtëson BE-ja. "Në rastin e Serbisë progresi në

normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve me Kosovën mbetet element kyç në përputhje me kornizën negociuese për Serbinë", thuhet në dokument.

Sipas metodologjisë së re, shtetet anëtare të BE-së do të kenë më shumë mundësi që të jenë të përfshira në monitorimin e procesit, duke përfshirë edhe kontributin e tyre në përmbajtjen e Raportit të Progresit si dhe në praninë e ekspertëve të shteteve anëtare në terren. Po ashtu, do të ketë më shumë takime në nivel politik midis BE-së dhe vendeve candidate si përmes Këshillit për Stabilizim Asociim, ashtu edhe me takime së paku një herë në vit në nivel të konferencave ndërqeveritare.

Rëndom, konferenca të tilla mes BE-së dhe një vendi që negocion për anëtarësim zhvillohen vetëm për të hapur apo mbyllur kapitujt negociues. Por, tani propozimi

është që takime të tilla të mos varen vetëm nga hapja e kapitujve, por të jenë edhe një forum politik, ku mund të diskutohen prioritetet dhe dinamikat e procesit.

Me metodologjinë e re, përmes së cilës BE-ja dëshiron ta bëjë procesin shumë të parashikueshëm, janë paraparë edhe masat korrektuese dhe sanksionet në rast se Mali i Zi apo Serbia kanë ngecje apo kthim prapa për zbatimin e obligimeve në kapitujt negociues, sidomos në ato që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe fushën e drejtësisë. Metodologjia e re ishte miratuar në BE me propozimin e Francës, që së bashku me Holandën kishin bllokuar vendimin për nisjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Pas miratimit të kësaj metodologjie, Këshilli kishte arritur ta merrte pëlqimin e të 27 shteteve anëtare për t'i nisur

negociatat me këto dy shtete. Por, për këto dy shtete ende nuk është miratuar korniza negociuese, pa të cilën as Tirana dhe as Shkupi zyrtar nuk mund t'i nisin formalisht negociatat për anëtarësim në BE.

Mali i Zi dhe Serbia para disa vjetësh kanë nisur negociatat për anëtarësim dhe deri më tani këto dy shtete kanë mbyllur vetëm një numër të kufizuar të kapitujve, Mali i Zi tre dhe Serbia vetëm dy. Mali i Zi ka hapur të gjithë kapitujt negociues, ndërsa Serbia deri më tani ka hapur 18 kapituj. Mbështetësit e metodologjisë së re kanë argumentuar se qëllimi i saj është që nëse shtetet candidate vërtet janë të gatshme t'i përmbushin kushtet, do të përshpejtohet edhe procesi i negociatave të anëtarësimit. Prandaj, edhe kanë shprehur bindjen se Mali i Zi dhe Serbia do të jenë të interesuara që edhe ndaj tyre të përdoret kjo metodologji e re. (rel)



Dogana konfiskon 45 telefona mobil dhe disa produkte farmaceutike



PRISHTINË, 17 MARS (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka arritur të parandalojë tri raste të ndara të kontrabandës. Gjatë aksionit të Doganës janë kapur disa produkte farmaceutike dhe 45 telefona. "Njësit e Doganës kanë arritur ta parandalojnë kontrabandën në tri raste të ndara. Fillimisht Dogana e Kosovës në bashkëpunim me Inspektoratin Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë ka marrë pjesë në kontrollin e

një barnatore në Pejë, ku edhe është gjetur një hapësirë në pjesën e fundit të subjektit e punuar posaçërisht për fshehjen e barnave të kontrabanduara. Asnjë nga barnat e gjetura në këtë hapësirë të fshehur nuk kishin banderola të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, një plan veprimi i implementuar në pikëkalimin e Hanit të Elezit ka zbuluar dy tentim kontrabandime. Në rastin e

parë në një automjet udhëtarësh në një hapësirë të fshehtë postfabrikante janë gjetur 45 telefona celularë. Në rastin e dytë në një autobus udhëtarësh është gjetur një sasi e konsiderueshme e produkteve farmaceutike/hormone për stimulim të fekondimit artificial. Në të tri rastet mallrat janë konfiskuar si dhe ka vazhduar procedura kundërvajtëse", ka njoftuar Dogana e Kosovës.

As sot nuk ka transport publik, paralajmërohet protestë për të premtën

Kryetari i Shoqatës së Transportuesve Rrugorë të Udhëtarëve, Ruzhdi Kurtishaj, ka thënë se këshilli drejtues i kësaj shoqate ka marrë vendim që greva për mosqarkullim të transportit rrugor të udhëtarëve të vazhdojë edhe sot (e enjte), ndërsa të premtën të gjithë operatorët e transportit do të defilojnë me autobus në Prishtinë në shenjë pakënaqësie për mosrealizimin e marrëveshjes me qeverinë për subvencionim të humbjeve ekonomike që kanë pasur operatorët e transportit publik



gathëm të takohen për, siç ka thënë ai, gjetjen e një zgjidhje të favorshme për këta operatorë. "Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, kërkon nga Shoqata e Transportuesve të Udhëtarëve, që sa më parë t'i kthejnë shërbimet për qytetarët, ndërkohë që shpreh gatishmërinë për diskutim me përfaqësuesit e këtij sektori me qëllim të gjetjes së një zgjidhje sa

më të favorshme", thuhet në njoftimin e qeverisë. Po ashtu, Zyra e Kryeministrit sqaron se bizneset e sektorit të transportit të udhëtarëve kanë qenë përfitues nga masat e Qeverisë së Kosovës. "Në vitin 2020 dhe 2021, Qeveria e Kosovës ka ofruar mbështetje financiare direkte dhe indirekte për të gjitha bizneset. Bizneset e sektorit të transportit të

udhëtarëve kanë qenë përfitues nga masat e qeverisë (për shembull, pagesa prej 290 eurove për numër të të punësuarve, pagesa e 50 për qind të qirasë, pagesa e 170 eurove). Pandemia Covid-19 ka prekur shumë sektorë dhe është e pamundur që shteti të kompensojë çdo humbje që kanë pasur bizneset", thuhet në njoftimin e qeverisë.

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 MARS - Këshilli Drejtues i Shoqatës së Transportuesve Rrugorë të Udhëtarëve ka marrë vendim që të premtën të defilojë me autobus në Prishtinë në shenjë pakënaqësie për mosrealizimin e marrëveshjes me qeverinë për subvencionim të humbjeve ekonomike që kanë pasur operatorët e transportit publik. Kryetari i kësaj shoqate, Ruzhdi Kurtishaj, ka thënë se të premtën nga ora 10:00 do të defilojnë me autobusë nëpër rrugët e Prishtinës për të përfunduar te ndërtesa e qeverisë. Ai ka folur

edhe për masat e tjera që mund të merren nga transportuesit. "Në bazë të reflektimit të qeverisë do të merren edhe vendimet e tjera. Kemi unitet për ta vazhduar grevën deri në realizimin përfundimtar të kërkesave tona. Dy ditët e para do të jenë vetëm grevë për shkak të pandemisë, ndërsa të premtën autobusët nga të gjitha komunat e Kosovës do të defilojnë në Prishtinë si lloj proteste. Koha e premtimeve ka kaluar. Tani duhet zbatim i marrëveshjes që kemi. Sot më së paku do të dëshironim të ishim në protestë", ka thënë ai.

Pas kësaj greve ka reaguar kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, duke thënë se janë të

Legalizimi i ndërtimeve pritet të sjellë përfitime për qytetarët

PRISHTINË, 17 MARS (ER) - Legalizimi i ndërtimeve pa leje pritet të sjellë përfitime për qytetarët e Kosovës dhe se është i madh potenciali i humbur ekonomik nga pamundësia e shfrytëzimit të pronave të legalizuara. Kështu u tha në Forumin virtual për legalizimin e ndërtimeve pa leje të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Drejtori ekzekutiv i OEAK-ut, Arian Zeka, ka deklaruar se procesi i legalizimit sjell përfitime shumëdimensionale për qytetarët dhe sektorin privat, duke nisur nga shfrytëzimi i papenguar i të drejtave pronësore, por edhe vënia e këtyre pronave në funksion të zhvillimit ekonomik. Zeka ka thënë se është i madh potenciali i humbur ekonomik nga pamundësia e shfrytëzimit të ndërtimeve pa leje si hipotekë për qasje në financa, por edhe për aktivitete afariste dhe investive.

Drejtori i Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, Servet Spahiu, ka

thënë se në përgjithësi ekziston një rritje e interesimit të qytetarëve për legalizim. Ai ka theksuar se në Komunën e Prishtinës dhe Graçanicës janë finalizuar rreth 500 regjistrime në kadastrë të ndërtimeve të legalizuara, të cilat bashkërisht arrijnë një vlerë të tregut deri në 96 milion euro.

Më tutje, Spahiu ka folur mbi aplikacionin e Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e lëndëve në proces të legalizimit, me ç'rast ka thënë se i njëjti është një vegël shumë e rëndësishme që ua bën të mundshme komunave administrimin dhe përcjelljen më të lehtë të të gjithë hapave të trajtimit të një lënde. Ai ka potencuar bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë Kadastrale në këtë proces, si dhe i ka ftuar të gjitha komunat që ta zbatojnë programin e legalizimit përmes njoftimit të qytetarëve të tyre mbi procedurat, bashkëpunimin ndërsektorial brenda komunës, zbatimin e udhëzimeve të nxjerra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për regjistrimin në kadastrë të ndërtimeve të legalizuara, dhe përdorimin e rregullt dhe të plotë të



aplikacionit për regjistrimin e lëndëve në proces të legalizimit.

Ardian Olluri, udhëheqës i Task Forcës së Legalizimit dhe drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, duke folur mbi procesin e legalizimit në këtë komunë, si dhe mësimet e deritanishme nga i njëjti, ka thënë se Komuna e Prishtinës ka krijuar një sektor të veçantë për legalizim, i cili përmes

kapaciteteve të zgjeruara profesionale trajton kërkesat për legalizim të ndërtimeve. Olluri ka shtuar se komuna në vazhdimësi u bënë thirrje qytetarëve ta shfrytëzojnë mundësinë për legalizim.

Avni Ahmeti, kryeshef ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka folur për rëndësinë e regjistrimit të ndërtimeve në kadastrë dhe përfitimet e qytetarëve nga ky proces, nga

qartësia pronësore, mbrojtja juridike, bartja e sigurt e së drejtës pronësore përmes shitblerjes dhe trashëgimisë dhe së fundi mundësia për hipotekim.

Ahmeti ka thënë se agjencia që ai drejton ka qenë promotore e legalizimit që nga fillimi, duke konsideruar këtë proces si një nga shtyllat kryesore për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (9)

Cili ka qenë roli i Shqipërisë në demonstrata?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Unë nuk e di se si kanë rjedhur punët në takimet e veçanta, sidomos në bisedat kokë më kokë apo me tre pjesëmarrës, në njësitë e larta të shtetit shqiptar. Nuk e di nëse janë marrë vendime të fshehta dhe është fakt se, përfshi ata për ndërrimet e pushtetit dhe të sistemit, çka ishin jetikë të ndërroreshin, ende nuk kanë dalë dokument të tjerë, veç atyre që njiheshin që asaj kohe ose u bënë të njohur pak më vonë. Nuk e di as nëse dashuria që Enver Hoxha shfaqte në publik për Kosovën ishte e stisur apo e vërtetë.

Kam qenë rastësisht në një takim të tij me motrën e Xhafer Spahiut, anëtar i udhëheqjes së lartë të shtetit shqiptar, i cili, në mos gaboj, e kishte prejardhjen nga Gjakova. Dhe e motra sapo kishte ardhur për vizitë tek ai. Me sa duket ata po shkonin ti uronin ditëlindjen Enver Hoxhës dhe u takuan në një mjedis ku ishin të pranishëm edhe disa gazetarë. Dikush i tha Enverit se Xhafer Spahiut po vinte me motrën e tij, nga Kosova, të cilën nuk e kishte parë prej vitesh. Enveri iu afrua asaj, hapi krahët, e mori mes tyre dhe i tha: "Motra ime, po vdes pa e parë Kosovën". Gjithçka mund të kishte qenë shfaqje, por, në fakt, kur deshëm ta botonim këtë ngjarje, nuk na u lejua, duke arsyetuar se kjo ishte diçka vetjake e jetës së udhëheqësit.

Unë i takoj atij grupi njerëzish që as nuk mund të marrë kënd në mbrojtje dhe as nuk mund të fajësojë dikë. Unë përqipem t'i sjell faktet ashtu si i kam përjetuar, pa bërë komentet e tyre, sepse, në raste të tilla, si janë ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë, shumëçka do të ishte e tepërt. Ndonëse nuk është aspak e tepërt të analizohet qëndrimi i shtetit shqiptar në këtë periudhë.

Qëndrimi i Shqipërisë ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme, sidomos për vetë pjesëmarrësit në kryengritje. Mbështetja publike e hapur, e drejtpërdrejtë dhe e vendosur e Shqipërisë kishte për ta edhe kuptimin e gatishmërisë për të rrezikuar e për të shkuar edhe më tej. Nëse Shqipëria do të heshtte, thyerja e tyre do të ishte jashtëzakonisht e madhe. Nëse Shqipëria do të kishte dalë kundër kërkesave të tyre, atëherë do të kishim pasur një thyerje historike, që vështirë se mund të ndreqej ndonjëherë.

Për fat ndodhi e kundërta e asaj që, ndoshta, kishin menduar në Beograd. Ndodhi ajo që kishin pritur demonstruesit: përkrahja pa ekuivok nga ana e shtetit shqiptar dhe kjo, edhe në kushtet e rënda të gjendjes së jashtëzakonshme, do të ishte një mbështetje shumë e madhe për të vazhduar më tej.

Sidoqoftë, shumë pyetje janë shtruar që atëherë, shumicën e të cilave e shtrova edhe unë në fillimin e këtyre shënimeve, të cilat, e theksoj, kanë më shumë karakterin e njohurive të mija vetjake, se sa synimin e një analize shkencore.

Le t'i marrim disa prej tyre qetësisht, pa dashur të përbalim ose të heqim baltën që është hedhur. Le të kthehemi edhe një herë me mendje në vitin 1981 dhe, duke e pasur të qartë se çfarë ndodhte në Kosovë, të analizojmë atë që ndodhte në shtetin shqiptar. Sepse, duke qenë si dy anë komunikuese, duam apo s'duam, deri në një ditë të pritshme, jemi ngërthyer nga fati i këtyre enëve.

Që në ditët e para pas ngjarjeve të marsit të vitit 1981 janë ngritur pyetje të cilat bëhen edhe kësaj dite. Cili ka qenë roli i Shqipërisë në demonstrata? A ishin ato të përgatitura dhe të drejtuara nga shteti shqiptar dhe strukturat e tij të fshehta apo gjithçka kishte ngjarë pa dijeninë e tij dhe shteti shqiptar ishte zënë në befasi? A ishin ato të mirorganizuara nga shteti shqiptar, qoftë edhe për të spostuar vëmendjen nga problemet që po i rriteshin apo shteti shqiptar kërkonte të shpejtonte ritmet e ngjarjeve që mund të vinin? A kishte dijeni drejtuesi i atëhershëm i shtetit shqiptar, Enver Hoxha, apo gjithçka e kishin bërë ndihmësit e tij, pa e vënë atë në dijeni?

Strukturat drejtuese, shtetërore dhe partiake të kohës, në Kosovë dhe në Jugosllavi, pa përfshirë në të gjitha republikat dhe në krahinën e atëhershme të Vojvodinës, pas vetëm pak ditësh heshtje, u sulën kundër

Shqipërisë, duke e akuzuar atë se, pas gjithçkaje që kishte ndodhur, ishte dora e saj dhe e sigurimit të shtetit shqiptar. Akuzat ishin një kor i përbashkët, te i cili, nga shqiptimi, nuk dallohej nëse ishin slovenë, kroatë, boshnjakë a malazezë, por ishte shumë e qartë kur ishin serbë e maqedonas. Çuditërisht, nga po të njëjtat grupacione në Kosovë, - pra thellësisht titistë dhe udbashë -, kjo akuzë, ndonëse më e sofistikuar, ngrihet edhe në ditët e sotme, në mbledhjet e turpshme e famëzeza të diferencimit. Nuk është për t'u çuditur se diçka e tillë ndodh. Akuzuesi kryesor i ngjarjeve të marsit 1981 dhe përfutuesi më i madh i tyre, Azem Vllasi u rikthye sërish, qoftë edhe përkohësisht, në zyrat e vjetra, si këshilltar i kryeministrit Kosumi. Kjo ishte krejtësisht ndryshe nga sa mund të ishte menduar, kur merret parasysh se, pas demonstratave të vitit 1981, zoti Kosumi do të dënohej me 15 vjet burgim të rëndë, si një prej organizatorëve të saj.

Duhet besuar dhe është për t'u besuar, se shteti shqiptar, i cili i kushtonte një vëmendje të veçantë vëzhgimit dhe ngritjes së strukturave të kundërbulimit kudo që e shihte të nevojshme dhe çfarë duhet pranuar se e bënte mjeshtërisht, nuk do të rrinte dorë jashtë nga shtrirja e tij në Jugosllavi e, sidomos, në Kosovë. Mund të mendohet se këtu e kishte edhe më të lehtë, pasi njerëzit ishin shqiptarë, që e donin deri në dhimbje Shqipërinë dhe shtetin shqiptar, që e kishin ushqyer ëndrrën e bashkimit dhe jetesës së përbashkët, dhe që do të kishin vepruar njëloj, edhe sikur në Shqipëri të vazhdonte të qeveriste monarkia e Zogut.

Është e besueshme se në Kosovë ka pasur njerëz që kanë punuar për shtetin shqiptar, ashtu si në Shqipëri nuk kanë qenë të paktë ata që kanë punuar për shërbimet sekrete jugosllave. Por ka një dallim rrënjësor mes tyre dhe bashkëpunëtorëve të UDB-së, qofshin këto të fundit në Kosovë apo në Shqipëri. Bile, mund të thuhet se nuk kishte asnjë lloj

krahësimi mes tyre. Ata, që kishin pranuar të punonin për shtetin shqiptar, nuk e bënë këtë sepse donin grada apo tituj, se ishin nevojtarë dhe kishin hallin e bukës së gojës, apo të një jete në luks. Ata kishin ëndërrime e synime të tjera. Lidhja e tyre, qoftë organizative apo strukturore me shtetin shqiptar, ishte preludi i asaj që mendohej se do të vinte, bashkimi i trojeve, dhe për këtë ata kishin sakrifikuar e do të sakrifikonin gjithçka.

Në të kundërtën e tyre, udbashët, dyfish të shitur, si bashkëpunëtorë të sigurimit që kishte robëruar vendin e tyre dhe në dëm të interesave jetike të Kosovës, janë faqja më e errët dhe më makabre e historisë së Kosovës në 50 vitet e fundit. Asnjëherë, në asnjë kohë, Kosova nuk ka pasur këso lloj mostrash të përbindshme, të cilët, dy herë të kuq dhe dy herë të zinj, titistë si ideologji dhe udbashë si profesion, janë turpi i çdo vendi. Çuditërisht e jo çuditërisht, këta njerëz, edhe atëherë, edhe sot, kanë të njëjtin qëndrim ndaj ngjarjeve të vitit 1981.

Tani që kanë kaluar më shumë se 40 vite mund të them me bindje se shteti shqiptar është zënë në befasi nga ngjarjet e vitit 1981. Ai nuk e ka pritur këtë, qoftë edhe për shkak të rrethanave disi të veçanta që ishin krijuar në parangjarjet e demonstratave të marsit.

Ishte një periudhë disi zbutjeje në marrëdhëniet mes dy shteteve. Drejtuesit e lartë të shtetit shqiptar sikur e kishin pranuar 'luftën e heshtur' me regjimin titist se cili do të influenconte më shumë tek tjetri, përmes shkëmbimesh kulturore e njerëzore, kontakteve, vëzhgimit të drejtpërdrejtë e kështu me radhë. Që nga ndërprerja e marrëdhënieve mes dy shteteve, nuk kishte ndodhur asnjëherë një gjë e tillë. Dhe nga shndërrimet që po ndodhnin marramendshëm shpejt, të dy regjimet, sikur kishin vënë në lojë atë që do të ndodhte në të ardhmen. Afërsia po bëhej gjithnjë e më e ndjeshme,


kontaktet po bëheshin të zakonshme, njësimi i gjuhës shqipe dhe pranimi i teksteve të shtetit shqiptar në programet mësimore të Kosovës (duke hequr vetëm citimet politike), po bëheshin dukuri e natyrshme. Në këto kushte, si duket, shteti shqiptar nuk e kishte të menduar se mund të ndodhte në Kosovë, diçka e tillë si demonstratat e vitit 1981.

Regjimi titist kishte qenë i bindur se nga kontaktet do të rritej ndikimi i tyre, qoftë edhe për shkak se në Shqipëri, krahas të merituarve, u dërguan, nën gjithfarë petku, edhe bashkëpunëtorët e fshehtë të sigurimit serb. Shkrimtari Mehmet Kraja, në librin e tij "Vite të humbura", duke treguar për pasudhëtimin e tij të parë në Shqipëri, së bashku me dy kolegë të "Rilindjes", dëshmon edhe për faktin se bashkudhëtarët e tij gazetarë, në zyrat e Prishtinës, po grindeshin me njëri-tjetrin se kujt i takonte "nderi" ta përpilonte informacionin për UDB-në.

Ndryshe nga sa ishte pritur në Beograd apo në Prishtinë, mes dy përpjekjeve, ishte e natyrshme që influenza e shtetit shqiptar të ishte më e madhe. Duhet pranuar se në këtë kohë, në Shqipëri, niveli arsimor e kulturor i botimeve dhe i rrjeteve të informimit, universiteti dhe institutet, njerëzit përgjithësisht, ishin më të ngritur. Ndjenja për Kosovën ishte në zenit të saj. Nga ana tjetër, ata që vinin nga Kosova në Shqipëri kishin marrë me vete, në radhë të parë, mallin dhe nuk mund t'i praninonin aq lehtë kundërshtitë që dukeshin. Ishte një kohë kur po bëhej e zakonshme të udhëtoje për në Prishtinë dhe të takohesh me shokët e të njohurit; ishte bërë e zakonshme që libri shqip të ishte i njëjtë si në Tiranë ashtu edhe në Prishtinë. Shteti shqiptar, në këtë kohë, mendonte se duhej pritur, se nuk duhej ngutur dhe se, ngutja pikërisht në këtë kohë, mund të sillte djegien e etapave. Mirëpo ndodhi e kundërta, ajo solli përshtetimin e proceseve.

(Vijon)





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina dhe Dukagjini, në gjysmëfinale të Kupës



FC Prishtina dhe Dukagjini janë dy klubet e para që kanë siguruar kalimin në gjysmëfinale. Sot (e enjte) mësohen dy gjysmëfinalistët e tjerë. Do të përballen Istogu - A & N dhe Trepça '89 - Llap

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 MARS - Fituesja në fuqi e Kupës, FC Prishtina, ka bërë një hap të madh drejt mbrojtjes së këtij trofeu pasi të mërkurën është kualifikuar në gjysmëfinale. Në fakt, skuadra kryeqytetase pas penalltive e mposhti Feronikelin në Drenas. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat 0-0, kurse në penallti më e suksesshme doli skuadra kryeqytetase që triumfoi me rezultat 4-2. Kjo është hera e dhjetë që Prishtina kualifikohet radhazi në këtë fazë të garës së Kupës. Në gjysmëfinale të Kupës, të mërkurën është kualifikuar edhe

skuadra e Dukagjinit të Klinës, e cila e ka mposhtur Drenicën me rezultat minimal 1-0. Në minutën e 76 Jeton Dushi e shënoi golin e vetëm në këtë ndeshje që i mundëson skuadrës nga Liga e Parë të kualifikohet në mesin e katër klubeve më të mira në Kupë. Ky është një sukses i madh për skuadrën nga Klina, e cila në të kaluarën dy herë ishte kualifikuar në finale të Kupës, por asnjëherë nuk e kishte fituar këtë trofe. Pas eliminimit të Drenicës, Bledar Devolli ka paralajmëruar se do të japë dorëheqje nga posti i trajnerit. "Nuk kam çfarë ta analizoj ndeshjen. Kundërshtari me fat shënoj, por çka të flas për futboll kur anësori e kishte dorën në gips.

Është e kotë. Më vjen keq për ata që investojnë në sport. Më duket se po punojmë kot. Do të flas me presidentin dhe do ta shoh pozitën time këtu. Ndoshta mund ta mbyll punën këtu", ka thënë Devolli pas ndeshjes. Ndërsa sot (e enjte) do të zhvillohen dy ndeshjet e radhës së çerekfinale. Ndeshja kryesore zhvillohet në Mitrovicë, ku Trepça '89 e pret skuadrën e Llapit. Të dyja skuadrat kanë synime të mëdha në garën e Kupës, e cila i siguron një vend në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës. Në ndeshjen tjetër në stadiumin "Demush Mavraj" në Istog përballen dy skuadrat nga Liga e Parë, Istogu dhe A & N.

SHKURT

Josa fiton gjyqin në FIFA ndaj Prishtinës

Trajneri Mirel Josa e ka fituar gjyqin në FIFA pas padisë të ngritur ndaj skuadrës së Prishtinës. 57-vjeçari kishte kontratë trevjeçare me ekipi kryeqytetas të Kosovës, por pas dy vjetësh, përkatësisht në shtator 2019, Josa ishte shkarkuar nga detyra e trajnerit. Drejtuesit e Prishtinës nuk kishin shlyer detyrimin financiar për periudhën e mbetur të kontratës, teksa FIFA i ka dhënë të drejtë Josës. "Indeksonline" bën të ditur që Prishtina duhet t'ia paguajë 45 mijë euro Josës, 17 mijë euro nga pagat e papaguara dhe pjesa tjetër si dënim nga FIFA për mosrespektim të kontratës.

KOK-u mbështet kampin përgatitor të Shenjëtarisë

Komiteti Olimpik i Kosovës po vazhdon t'i mbështesë sportistët të cilët po i vazhdojnë përgatitjet në kërkim të normës olimpike "Tokio 2020". Këtë herë KOK-u do t'i mbulojë shpenzimet e kampit përgatitor të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës (FSSHK), i cili mbahet prej sot e deri më 27 mars 2021 në poligonin e Shenjëtarisë Sportive, që ndodhet në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Heqja e shpenzimeve nga KOK-u vjen pas kërkesës së Federatës për ta kompensuar mbështetjen 10-ditëshe të dy sportistëve elitare, Drilon Ibrahim dhe Urata Rama, bursistë të KOK-ut për Lojërat Olimpike Tokio 2020. Me vendim të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut, sportistët elitare, varësisht nga kategoria në të cilën ndodhen, mbështetën deri në 80 ditë përgatitje për gjashtë muajt e parë të këtij viti për kampet që organizohen në Kosovë dhe jashtë vendit. Kampi i shenjëtarisë do të udhëhiqet nga ekspertja me licencë ndërkombëtare, Lumturi Pepa nga Shqipëria.

Skënderbeu kalon në gjysmëfinalen të Kupës

Nuk ka asnjë surprizë edhe në stadiumin "Selman Stërmasi", teksa Skënderbeu ka arritur që të marrë një fitore 3-1 ndaj Dinamos duke siguruar një biletë për në gjysmëfinalen e Kupës së Shqipërisë. Në minutën e 21-të ishte sulmuesi Alfred Mensah që zhbllkoi sfidën mes protestave të kryeqytetasve, për një marrje të topit me dorë para se ta dërgonte topin në rrjetë, por për arbitrin goli ishte i rregullt. Dinamo reagoi menjëherë dhe krijoi disa mundësi shënimi, por në momentin më të mirë të bluve, ishte Elvi Berisha që u lirua bukur në zonë dhe arriti ta dërgojë topin në rrjetë për herë të dytë. Për ta vulosur rezultatit mendoj sulmuesi shkodran Belajdi Pusi, që pasi mori një pasim fantastik nga Berisha, shtyu topin në rrjetë. Dinamo ngushtoi disavantazhin me anë të brazilianit Wellber, ndërsa më vonë pati një sërë mundësish për ta rihapur ndeshjen.

Kosova mësoi kundërshtarët në kualifikimet e ardhshme për Evropian

PRISHTINË, 17 MARS - Hendbollistet e Përfaqësueses së Kosovës në Austri të premtën e të shtunën i luan ndeshjet e fazës së parë kualifikuese për Botërorin 2021. Por të mërkurën hendbollistet kanë mësuar edhe kundërshtarët e fazës së parë kualifikuese për Evropianin 2022. Kosova do të garoj në Grupin A së bashku

me Portugalinë, Luksemburgun dhe Qipron. Kosova për short ishte në vazon e dytë. Gjithsej në fazën e parë kualifikuese marrin pjesë 11 ekipe kombëtare të hendbollisteve që janë ndarë në tri grupe. Fituesi i grupit avancoi në kualifikimet e rregullta dhe ky natyrisht mbetet synim i vashave të Kosovës. Ndeshjet e fazës së

parë kualifikuese për "Euro 2022" do të zhvillohen prej 31 majit deri më 6 qershor. Ndërsa kualifikimet e rregullta fillojnë në tetor të këtij viti. Ndeshjet e grupit të Kosovës pritet të luhen në Portugal. "Euro 2022" mbahet në Slloveni, Maqedoni të Veriut dhe në Mal të Zi në dhjetor të vitit të ardhshëm.



Leclerc: Mos prisni asnjë mrekulli nga Ferrari

MONACO, 17 MARS - Kur duhen edhe dhjetë ditë që të nisë sezoni 2021 në Formula 1, piloti monogask i Ferrarit, Charles Leclerc, shprehet se edhe ky botëror nuk ka për të qenë i lehtë për "kokëkuqen". Edhe në testet e zhvilluara fundjavën e kaluar në Bahrein, makina

italiane nuk ishte mes më të mirave, edhe pse është një njëvendëshe më e mirë se ajo e vitit të kaluar. "U munduam që në tri ditë të zhvillojmë sa më shumë xhiro dhe të kryejmë sa më shumë punë. Shfrytëzuar në maksimum çdo mundësi që patëm, bëmë shumë kilometra

në pistë. Për pasojë, është ende herët për të folur për makinën e këtij sezoni. Kur flasim për ta rikthyer Ferrarin në majë, nuk i referohemi këtij viti", ka thënë Charles Leclerc. "Duhet të jemi të gjithë realistë. Nuk mendoj se këtë vit do të duelojmë për titullin kampion. Ndaj, mos

prisni asnjë mrekulli nga Ferrari. Makina SF21 e këtij viti nuk është një revolucion, por një evolucion i asaj të vitit të kaluar. Ne do të përpqemi ta marrim maksimumin në Formula 1. Kjo nuk është një periudhë e mirë për Ferrarin e, po ashtu, edhe për ne, ndaj le të marrim më të



mirën e mundshme", ka shtuar Leclerc.

Challandesi publikon listën e futbollistëve për ndeshjet e marsit

PRISHTINË, 17 MARS - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për tri ndeshjet e këtij muaji: miqësoren kundër Lituaniës, më 24 mars dhe dy duelet kualifikuese për Botërorin "Katari 2022" kundër Suedisë, më 28 mars dhe kundër Spanjës, më 31 mars. I ftuar për këtë grumbullim ka qenë edhe sulmuesi i skuadrës Hammarby IF, Astrit Selmani, por për shkak se ka rezultuar pozitiv në Covid-19 nuk ka mundësi t'u bashkohet "dardanëve". Mesfushori Herolind Shala mungon për shkak të mungesës së paraqitjeve, kurse për herë të parë përfaqësueses do t'i bashkohet portieri Betim Halimi. Si zakonisht, lojtarët nga Kosova do të akomodohen në hotel "Emerald", ndërsa stërvitjen e parë do ta zhvillojnë të hënën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë me fillim nga ora 19:00.



LISTA E FUTBOLLISTËVE

Aro Muriç, Samir Ujkani, Visar Bekaj, Betim Halimi, Mërgim Vojvoda, Florent Hadërgjonaj, Betim Fazliji, Fidan Aliti, Amir Rrahmani, Leart Paqarada, Ibrahim Dresheviq, Lirim Kastrati, Zymer Bytyqi, Hekuran Kryeziu, Idriz Voca, Valon Berisha, Besar Halimi, Bersant Celina, Bernard Berisha, Milot Rashica, Elbasan Rashani, Edon Zhegrova, Lirim Kastrati, Arbër Zeneli, Florent Hasani, Vedat Muriqi, Atdhe Nuhiu, Benjamin Kololli.

Lakersat arrin fitore bindëse ndaj Minnesotas

LOS ANXHELOS, 17 MARS - Moment i mirë për kampionët në fuqi të NBA-s. Pavarësisht prej mungesave me peshë si Anthony Davis apo spanjollit Marc Gasol, Los Angeles Lakers regjistroi fitoren e tretë rresht në NBA pasi mposhti me rezultatin e thellë 137-121 Minnesota Timberwolvesin. Pjesa e parë ishte thuajse e baraspeshuar ndërkohë që dallimin kalifornianët e bënë në fraksionin e dytë, për meritë edhe të mbretit James. LeBron e mbylli sfidën me një triple-double duke koleksionuar në total 25 pikë, 12 rikuperime poshtë tabelës dhe 12 asistime. Një paraqitje të shkëlqyer për Lakersat bëri edhe Harreli, autor i 25 pikëve, ndërkohë që Minnesotas nuk i mjaftuan 29 pikët e Karl Anthony-Towns dhe 29 të tjera nga Edwards. Aktualisht Lakersat pozicionohen të 3-ët në Perëndim me 27 fitore dhe 13 humbje. Nuk di të ndalet më Miami Heat që mori fitoren e 11-të në 12 ndeshjet e fundit pasi mposhti pa probleme Cleveland



Cavaliersin me rezultatin 113-98. Falë edhe 28 pikëve të realizuara nga Jimmy Butler, Heats u ngjiten në vendin e katër në konferencën e Lindjes. Arriti suksesin e 29 sezonal në 39 takime Utah Jazz që triumfoi me rezultatin 117-109 Boston Celticsi, raporton "Supersport". Në "TD Garden", Jason Tatum dhe Jaylen Brown realizuan të dy së bashku 57 pikë, por as këto nuk mjaftuan për ta evituar humbjen e Celticsit pasi diferencën e bëri loja në grup e

Utah, me plot 6 basketbollistë të skuadrës nga "Salt Lake City" që arritën një kuotë pikësh me dy shifra. Me një Damian Lillard në formë të shkëlqyer u rikthye te fitorja edhe Portland Trail Blazersi që mposhti me rezultatin e ngushtë 125-124 New Orleans Pelicansin. Ishte thjesht fantastik Lillard në këtë duel pasi koleksionoi në total 50 pikë 6 rebounde dhe dhjetë asistime duke udhëhequr Blazzersin drejt suksesit të 23-të sezonal.

SHKURT

Sadiku shkruan historinë në Copa Libertadores

Armando Sadiku është bërë shqiptari i parë që merr pjesë në Copa Libertadores. Të martën mbrëma, Bolivia siguroi kalimin për në fazën finale të fazës para-eliminatore. Skuadra ku aktivizohet sulmuesi shqiptar shënoi fitore 5-0 ndaj Wanderersit, duke kaluar tutje me rezultatin e përgjithshëm 5-1. 29-vjeçari hyri në këtë ndeshje në minutën e 69-të, duke shkruar historinë në Copa Libertadores. Ndryshe, Armando Sadiku është pjesë e skuadrës nga Bolivia që nga janari i këtij viti.

Realin synon rikthimin e Hernandezit

Theo Hernandez është një ndër pikat e forta të skuadrës së Milanit dhe shpërthimi i tij me fanellën kuqezi ka surprizuar jo pak Real Madridit që kërkon ta rikthejë futbollistin në skuadër. Klubi nga Milanello e bleu kartonin e francezit pikërisht nga madrilet për shumën e 20 milionë euro në 2019-ën, por tani 23-vjeçari vlerësohet 50-60 milionë euro me një plusvalencë në favor të klubit italian. Mbrojtësi këtë sezon në 23-paraqitje ka realizuar në total 5 gola dhe vështirë se "dialli" do të privohet nga shërbimet e tij pavarësisht ofertave që mund të vijnë në drejtim të tij.

Ceferin: 'Euro 2020' do të zhvillohet me tifozë

Presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin ka përjashtuar kategorikisht çdo mundësi që ndeshjet e "Euro 2020" që do të zhvillohet këtë verë të luhen pa tifozë. Për momentin 11 qytete kanë garantuar që mund të plotësojnë kushtet sanitare për të pritur tifozë verën e ardhshme në impiantet e tyre ndërkohë që në dyshim janë Dublini dhe Glasgow pasi qeveria scoceze është shfaqur skeptike dhe pritet të mos lejojë praninë e tifozëve në një nga dy qytetet që mund të zgjidhet për të pritur ndeshjet e "Euro 2020". "Ne jemi duke punuar për skenarë të ndryshëm, por e vetmja garanci që mund të japim është se opsioni për të luajtur ndonjë ndeshje të Euro 2020 në një stadium të zbrazët është përjashtuar. Çdo qytet do të duhet të sigurojë që do të ketë tifozë në tribuna gjatë ndeshjeve të tyre. Skenari ideal është të luash turneun në 12 vendet e paracaktuara, por nëse kjo nuk është e mundur do të vazhdojë në 10 ose 11 vende", ka thënë Ceferin. "Euro 2020" ishte në program për t'u luajtur verën e kaluar por u shty për këtë vit për shkak të pandemisë Covid-19. Kompeticioni i dytë më i rëndësishëm në rang kombëtarësh pas Kupës së Botës do të startojë në 11 qershor të këtij viti dhe do të përfundojë më 12 korrik.

Gasperini: Menduam se mund të bënim më mirë kundër Realit

Atalanta u eliminua nga Real Madrid në Ligën e Kampionëve dhe trajneri Gian Piero Gasperini ka thënë se nuk do të ndryshonte asnjë nga zgjedhjet e bëra para ndeshjes. Ai ka thënë se pritet kanë qenë më të mëdha për të dyja ndeshjet ndaj Realit. "Pa asnjë diskutim do të kisha bërë të njëjtat zgjedhje. Goli i parë, penallti dhe madje edhe goli në ndeshjen e parë e komprometuan kualifikimin, që gjithsesi do të ishte i vështirë. Kur dhuroni gola të tilla normalisht që bëhet akoma edhe më e vështirë. Është për të ardhur keq, pasi menduam se mund të bënim më mirë", ka thënë Gasperini. "Ndeshja mori rrjedhë të gabuar dhe ishte pjesërisht faji ynë, ndaj u bë shumë e vështirë. Këto përvoja janë gjithnjë fantastike për lojtarët, trajnerin dhe klubin, pasi përballemi me më të mirët në nivel ndërkombëtar. Duhet të jemi të kënaqur, pasi eliminuam një skuadër si Ajaxi dhe kaluam në një grup me Liverpoolin. Shpresonim që mund të bënim më mirë në të dyja ndeshjet kundër Real Madrid", ka shtuar Gasperini.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Nr.prot.: 788/21, Datë: 16.03.2021

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues (KD), numër 319/16, të datës 06.06.2016, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), me datë 16.03.2021, shpallë:

OFERTË PËR LËSHIMIN E HAPËSIRAVE ME QIRA PËR BUFE

Kushtet dhe kriteret për lëshimin e hapësirave me qira për bufe:

- Hapësirat, të cilat janë ofertuar për qiradhënie, gjenden në katin përdhësë të objektit të UShAF, me një sipërfaqe prej 283.50 metër katrorë (m²) (kuzhina 28.50 m², banaku 18.00 m², bufe 110.50 m² dhe terasa e bufesë 126.50 m²);
- Qiramarrësi do ta ketë të drejtën që në hapësirat e marra me qira të bëjë përmirësime, meremetime dhe adaptime shtesë (duke mos rrezikuar për asnjë moment konstruksionin dhe stabilitetin e objektit), investime të cilat do të mbulohen nga vet qiramarrësi;
- Qiramarrësi do të ketë në dispozicion të gjitha pajisjet të cilat ndodhen në hapësirat që jepen me qira (inventar dhe kuzhinë);
- Qiramarrësi duhet të kompletojë sipas standardeve kuzhinën dhe inventarin me pajisje të cilat mungojnë;
- Qiradhënësi do të paguaj të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës, ujit, pastrimit, ngrohjes dhe sigurimit.

Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim:

Operatorët ekonomik të cilët marrin pjesë duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin;
- Numrin fiskal të biznesit;
- Të kenë aktivitet të hotelierisë apo gastronomisë për së paku 10 vite (të ofrojnë dëshmi);
- Të kenë së paku 50 punëtorë (lista e punëtorëve me dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës);
- Të kenë aktivitet aktual të hotelierisë apo gastronomisë së paku në 5 qendra (qytete të Kosovës, të dëshmuara me foto, video nga aktivitetet në lokalet e tyre, katalogje, menu apo materiale të tjera);
- Të kenë në tre vitet e fundit në total realizim financiar në fushën e hotelierisë apo gastronomisë së paku 600.000 (gjashtëqind mijë) euro (për vitet 2018, 2019 dhe 2020) (të ofrojnë dëshmi);
- Operatori ekonomik i cili është lider, duhet të plotësojë 100% të kriterëve dhe dokumenteve të kërkuara.

Kohëzgjatja e ofertës për shprehje të interesit dhe mënyra e aplikimit:

- Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur.
- Ofertat duhet të dorëzohen në Administratën e UShAF-it, zyra numër 008.
- Ofertat e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, nuk do të merren në shqyrtim.
- Kohëzgjatja për shpalljen e ofertës është e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike nga dita e publikimit të kësaj oferte, përkatësisht nga data 18.03.2021 deri më 01.04.2021.
- Të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë që paraprakisht t'i vizitojnë hapësirat në UShAF dhe t'i verifikojnë sipërfaqet e hapësirave, me datën 26.03.2021 nga ora 10:00 deri në ora 12:00.
- Ofertat dorëzohen në një zarf, në të cilin shkruhet "Ofertë për lëshimin e hapësirave me qira për bufe", brenda të cilit janë dy zarfe të tjera. Në njërin zarf vendoset i tërë dokumentacioni dhe materiali i kërkuar, ndërsa në zarrin tjetër vendoset vetëm çmimi i ofruar për metër katrorë (m²).
- Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur me datë 01.04.2021 nga ora 14:00 deri në ora 15:00.

Përzgjedhja e qiramarrësit:

- Qiramarrës do të përzgjidhet ofertuesi që plotëson kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar dhe ofron vlerën më të madhe të pagesës për metër katrorë (m²).

Kohëzgjatja e kontratës me qiramarrësin:

- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 10 vite.

E drejta e ankesës:

- Ankesa bëhet më së largu shtatë (7) ditë nga dita e përzgjedhjes së ofertuesit;
- Ankesa dorëzohet në UShAF, në zyrën numër 008.

NJOFTIM

Njoftojme të gjithë klientet se Kompania EUROPA 2 SH.P.K. me seli në RAHOVEC, ka marrë vendim të shuaj biznesin me numer të regjistrimit 810734724 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientet që kanë raporte Kreditore-Debitore në këte shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazete.

OBAVESTENJE

Obaveštavamo sve kupce da je kompanija EUROPA 2 SH.P.K. sa sedištem u RAHOVEC, odlučila da zatvori posao sa registracijskim brojem: 810734724 i imenovala likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Obaveštavaju se svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the company EUROPA 2 SHPK based in RAHOVEC, has decided to close the business with registration number: 810734724 and has appointed the liquidator for the development of the Liquidation procedure. All clients who have Credit-Debit reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ardita Hamdush Hyseni, shpall të pavlefshme Licencën e Punës, KO-20617-05-20. data 01.04.2015.

► Abdylbari Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Hasan Rexhaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VII shfmu "Heronjë e Kabashit" Korish.

► Erzen Ademaj shpall të pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

► Edona Hamiti shpalle te pavlefshme diplomen e SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

► Gzim Salja shpalle të pavlefshme dëftesat e vitit I,II të SHMLE "Hasan Prishtina".

► Ali Xhigoli shpalle të pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

► "Matoshi 99 O.P." shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70676656. Nr. UNIK 811195529, nr. fisk. 600499108.

► "Rembek" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330349888.

► Auto Shkolla "Baza-L" vazhdon ofertën me 50% zbritje deri më 20.03.2021. Gjilan.

► Jap banesë me qira afër 60 m², kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

